



LIDHJA E ARSIMTARËVE
DHE PRINDËRVE SHQIPTARË

NAIM FRASHËRI
ZVICËR

MËSIMI PLOTËSUES NË GJUHËN SHQIPE 2025/2026

Të nderuar prindër

1. Në shkollën e mësimi plotësues të gjuhës shqipe regjistrohen fëmijët e familjeve shqiptare që të marrin njohuri në gjuhën amtare shqipe dhe kulturën e atdheut. Njohja e gjuhës dhe kulturës amtare në radhë të parë formon identitetin kombëtar të fëmijës, e ndihmon në komunikimin e përditshëm me prindër, me të afërmit tjerë dhe e lidh me atdheun.

2. Qëllimi dhe rëndësia e shkollës së mësimi plotësues.

Njohuri të mira të gjuhës amtare shqipe

Shkolla ka për qëllim që fëmijët të përvetësojnë gjuhën shqipe, të flasin drejt dhe pa gabime, të lexojnë, të shkruajnë, të marrin njohuri gramatikore, histori kombëtare dhe gjeografi të atdheut.

Mësimi i një gjuhe të dytë/ dygjuhësia

Fëmija që e di mirë gjuhën shqipe e mëson më lehtë e më mirë frëngjishten, arrin sukses në shkollë dhe fitohet dygjuhësia.

Edukimi ndërkulturor

Mësimi plotësues përkrah nxënësit/et të jetojnë me sukses në dy kultura.

Kontaktet me familjen, me të afërmit dhe me bashkatdhetarët.

Njohuritë mbi kulturën e atdheut

Fëmijët mësojnë ta kuptojnë më mirë kulturën dhe mënyrën e jetesës së familjes dhe të atdheut.

Integrim më i mirë

Kush e njeh mirë gjuhën dhe kulturën e vet, integrohet më mirë në shoqëri dhe në raport me të tjerët ka më shumë tolerancë dhe mirëkuptim.

Shfrytëzimi në fushën e profesionit

Me një zotërim të mirë të dy gjuhëve të rinjtë kanë përparësi në fushën e profesioneve si në Zvicër ashtu edhe në Atdhe.

Parapërgatitja për një kthim eventual në Atdhe

Në të shumtën e vendeve është një përparësi e madhe që në rast të kthimit në atdhe të dëshmohet vijimi i mësimi plotësues.

3. **Në familje përdorni gjuhën shqipe!** Motivoni fëmijët të lexojnë libra në frëngjisht dhe shqip. Regjistroni fëmijët në mësimin shqip që të shihni suksesin e tyre.

4. Organizator i mësimit plotësues të gjuhës shqipe është Këshilli i Prindërve

Mësimi plotësues zhvillohet një herë në javë, pas orarit të rregullt të mësimit të shkollës zvicerane.

Në mësimin plotësues kyçen nxënësit nga klasa e I-rë (3e Harmos) deri të XI-tën. Mësimi është një herë në javë. Mbahet pasditeve kur fëmijët nuk kanë mësim në shkollën zvicerane. Shpërndarja e formularit të regjistrimit të nxënësve në mësimin plotësues bëhet përmes mësuesve të klasëve së shkollës zvicerane.

Posa të keni nënshkruar Formularin e regjistrimit, Përnjëherë duhet ta dërgoni te organizatorët e mësimit plotësues në këtë adresë:

z.Naser Ramabaja, Rue de l'Est 41, 2740 Moutier, ose përmes

Mail-it, naser_ramabaja@outlook.com Më së largu deri më 15 qershor 2025

Fletëparaqitja e nënshkruar nga prindi nënkupton një pjesëmarrje të rregullt të fëmijës në mësim. Nëse ai mungon ndonjëherë prindërit duhet t'i arsyetojnë mungesat. Organizatorët e mësimit ju njoftojnë për kohën e zhvillimit dhe vendin ku mbahet mësimi.

5. Notimi

Nxënësit që ndjekin mësimin plotësues vlerësohen për suksesin e arritur në mësim. Nota e gjuhës shqipe përshkruhet në librezën e notave të nxënësit. Në përfundim të shkollës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe nxënësit pajisen me certifikatë.

Moutier, më 7 shkurt 2025

Naser Ramabaja, kryetar i Këshilit të Lapsh-it , Jura